



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

Nr. 5544 Prot

Vlorë më 21.06.2022

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të ligjit Nr. 97 datët.06.10.2016 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (nenet 42,70,74,76,80,82) duke qënë se 2 (dy) punonjëse të kësaj Prokurorie me detyrë sekretare pranë Prokurorit do të marin lejen e lindjes është e domosdoshme të bëhet zëvendësimi i tyre për periudhën që ato do të jenë me lejen e lindjes.

Nisur sa me lartë për këto 2 (dy) pozicione shpallet ky njoftimin për paraqitjen e kërkesave nga çdo i interesuar në konkurim për pozicionin Sekretares/it pranë Prokurorit në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

Kërkesat e përgjithshme për kandidatët :

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që lejojnë kryerjes e detyrës.
- Të mos jetë në ndjekje penale,apo i denuar me vendim të formës së prerë për çdo lloje vepre penale.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi.

Kërkesat e veçanta për kandidatët :

- 1 - Të jetë diplomuar në shkenca Juridike (bachelor + master)
- 2 – Te ketë përvojë profesionale të paktën 1 (një) vitë (apo çdo lloj përvojë tjetër që lidhet me Prokurorinë).
- 3 – Të ketë aftësi të mira kompjuterike, njohja e programeve baze.

Dokumentacioni i kërkuar

1. Kërkesë për aplikim
2. Jetëshkrim, (Nr. Kontakti, e-mail, dhe adresën e plotë të vendbanimit)
3. Fotokopje të kartës së identitetit
4. Fotokopje të diplomës dhe listën e notave (njëhësim të diplomës së huaj dhe konvertim të notave për aplikantin që ka studiuar jashtë shtetit)
5. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar (shoqëruar akt-vlerësimimi nga punëdhënësi në qoftë se ka.)
6. Vërtetim nga Gjykata.
7. Vërtetim nga Prokuroria.

8. Vërtetim të gjëndjes gjyqësore (dëshmi penaliteti).
9. Raport mjeko-ligjor (që vërteton aftësinë në punë).
10. Ç' do dokument tjetër (çertifikatë të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme, gjuhë e huaj etj.)

Konkurrimi do të ketë 2 (dy) faza dhe totali i pikëve është 100 (njëqindë).

1. Faza e parë :

Verifikimi paraprak i dokumentacionit të paraqitur nga secilin kandidat, (nëse ato plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta) gjithësej **15** (pesëmbëdhjetë) pikë.

2. Faza e dytë :

- Vlerësimi me shkrim **60** gjithësej (gjashtëdhjetë) pikë.
- Vlerësim i intervistës së strukturuar me gojë gjithësej **25** (njëzet e pesë) pikë.
- Kufiri minimal i pikëve për fituesin është **70** (shtatëdhjetë).

Ky njoftim do të dërgohet në Prokurorinë e Përgjithshme për shpallje në faqen zyrtare për një periudhë kohore **20** (njëzetë) ditësh, deri në datën **12.07.2021**, si dhe një kopje do të afishohet në hyrje të Prokurorisë këtu.

Dorëzimi i kërkesave do të bëhet çdo ditë nga ora **08⁰⁰ – 16⁰⁰** në zyrën e Protokollit, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë .

Për çdo informacion më të hollësishëm gjithë të interesuarit mund të paraqiten çdo ditë nga ora **08⁰⁰ – 16⁰⁰** në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

